



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-0/OPK</u>	Br. Prot. <u>01-989/16</u>
Prot. No.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>04-03-2016</u>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.03.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4179/15, për z. Jetullah Kabashi, Menaxher i Prokurimit në Komunën e Rahovecit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Jetullah Kabashi, Menaxher i Prokurimit në Komunën e Rahovecit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Zyrtari i lartë është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Kabashi ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmërues”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/975/16) në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesin privat N.P.H “Bufe Filo”. Me këtë rast zyrtari i lartë ka shmang gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

